




UK Health
Security
Agency



Çfarë pritet pas vaksinimit tuaj kundër KOVID 19



Informacion për njerëzit
që sapo kanë bërë një
vaksinë kundër KOVID 19

Zbuloni më shumë në nhs.uk/CovidVaccine



Përmbajtja

Cilat janë efektet anësore?

Kam dëgjuar se vaksinat mund të shkaktojnë perioda të parregullta ose gjakderdhje të papritur?

Çfarë duhet të bëj nëse jam i/e shqetësuar për simptomat e mia?

A ka efekte të tjera anësore më serioze?

A duhet të pres 15 minuta pas vaksinimit?

Kur mund të kthehem në aktivitetet e përditshme?

A do të më mbrojë vaksina?

Ju lutemi lexoni fletëpalosjen e informacionit të produktit për më shumë detaje mbi vaksinën tuaj, duke përfshirë efektet anësore të mundshme, duke kërkuar Coronavirus Yellow Card (Karta e verdhë e Koronavirusit).

Ju gjithashtu mund të raportoni efekte anësore të dyshuara në të njëjtën faqe interneti ose duke shkarkuar aplikacionin Yellow Card.



yellowcard.mhra.gov.uk

Personave që janë më të rrezikuar nga ndërlilikimet e koronavirusit (COVID-19) u ofrohet vaksinimi për COVID-19. Kjo fletëpalosje ju tregon se çfarë të prisni pasi të keni bërë vaksinimin tuaj.

Cilat janë efektet anësore?

Si të gjitha ilaçet edhe vaksinat mund të shkaktojnë efekte anësore. Shumica e tyre janë të lehta dhe afatshkurtra, dhe jo të gjithë i kanë ato. Efektet anësore të zakonshme të vaksinës COVID-19 fillojnë brenda një dite dhe mund të zgjasin për disa ditë.

Këto përfshijnë:

- të paturit e një ndjenjeje të dhimbshme, të rëndë dhe butësi në krahun ku keni bërë injeksionin tuaj
- ndjenjë lodhjeje
- dhimbje koke, dhimbje dhe të dridhura

Ju gjithashtu mund të keni simptoma të ngjashme me gripin me episode të dridhjeve dhe shkundjeve për një ose dy ditë. Megjithatë një temperaturë e lartë mund të tregojë gjithashtu se keni KOVID 19 ose një infeksion tjetër (shihni këshillat në faqen 4). Ju mund të pushoni dhe të merrni dozën normale të paracetamolit (ndiqni këshillat në paketim) për t'ju ndihmuar të ndiheni më mirë.

Një efekt anësor i pazakontë është ënjtja e gjëndrave në sqetull ose qafë në të njëjtën anë me krahun ku keni bërë vaksinën. Kjo mund të zgjasë për rreth 10 ditë, por nëse zgjat më shumë vizitoni mjekun tuaj. Nëse duhet të bëni një mamografi brenda disa javësh pas vaksinimit, atëherë duhet ta përmendni këtë kur të shkoni.

Kam dëgjuar se vaksinat mund të shkaktojnë perioda të parregullta ose gjakderdhje të papritur?

Problemët e menstruacioneve janë jashtëzakonisht të zakonshme dhe mund të shkaktohen nga një sërë faktorësh përfshirë stresin dhe sëmundje të tjera afatshkurtra.

Disa persona mund të përjetojnë perioda më të rënda se normale në një muaj apo më shumë pas vaksinimit. Ndërsa ndryshime të tjera të periodave janë raportuar nga disa njerëz pas vaksinimit, nuk ka asnjë provë që këto kanë qenë për shkak të vaksinës.

Çfarë duhet të bëj nëse jam i/e shqetësuar për simptomat e mia?

Këto simptoma zakonisht zgjasin më pak se një javë. Nëse simptomat tuaja duket se përkeqësohen ose nëse jeni të shqetësuar, telefononi NHS 111. Nëse kërkon këshilla nga një mjek ose infermiere, sigurohuni që t'i tregoni për vaksinimin tuaj (tregoni kartën e vaksinimit) në mënyrë që ata t'ju vlerësojnë siç duhet.

Ju gjithashtu mund të raportoni efekte anësore të dyshuara të vaksinave dhe ilaçeve përmes skemës së Yellow Card. Ju mund ta bëni këtë në internet duke kërkuar Yellow Card ose duke shkarkuar aplikacionin Yellow Card (shihni faqen 2).

A ka efekte të tjera anësore më serioze?

Janë raportuar raste të rralla të inflamacionit të zemrës (të quajtur miokardit ose perikardit) pas vaksinave Pfizer dhe Moderna COVID-19. Këto raste janë parë kryesisht tek meshkujt e rinj brenda disa ditësh pas vaksinimit.

Shumica e këtyre njerëzve u shëruan dhe u ndjenë më mirë pas pushimit dhe trajtimeve të thjeshta.



Ju duhet të kërkonti urgjentisht këshilla mjekësore nëse përjetoni:

- dhimbje gjoksi
- gulçim
- ndjenja e të paturit të një zemre që rreh shpejt, dridhet ose rreh fortë

A duhet të pres 15 minuta pas vaksinimit?

Kur përdorëm për herë të parë vaksinat Pfizer dhe Moderna, personat qëndruan mbrapa për t'u vëzhguar për 15 minuta pas vaksinimit të tyre. Për shkak të shkallës shumë të ulët të reaksioneve alergjike, vetëm personat me histori të alergjive serioze ose ata që kanë pasur një reagim ndaj një vaksinimi të mëparshëm ndaj KOVID 19 duhet të presin këtë kohë.

Megjithatë, për shkak të rrezikut të të fikët, askush nuk duhet t'i japë makinës për të paktën 15 minuta pas vaksinimit.

Kur mund të kthehem në aktivitetet e përditshme?

Ju duhet të jeni në gjendje të rifilloni aktivitetet që janë normale për ju për sa kohë që ndiheni mirë. Nëse krahu juaj është veçanërisht i lënduar, mund ta keni të vështirë ngritjen e peshave. Nëse nuk ndiheni mirë ose shumë të lodhur, duhet të pushoni dhe të shmangni përdorimin e makinerive ose drejtimin e automjetit.

A do të më mbrojë vaksina?

Është treguar se vaksinat kundër KOVID 19 që keni pasur reduktojnë mundësinë që ju të vuani nga sëmundja e rëndë KOVID 19.

Mund të duhen disa javë nga doza e parë që trupi juaj të krijojë mbrojtje. Trupi juaj duhet të fillojë të përgjigjet më shpejt (pas disa ditësh) pas çdo doze shtesë. Si të gjitha ilaçet asnjë vaksinë nuk është plotësisht efektive, kështu që duhet të vazhdoni të merrni masa paraprake të arsyeshme për të shmangur infeksionin. Disa njerëz mundet ta marrin ende KOVID 19 pavarësisht se kanë një vaksinë, por kjo duhet të jetë më pak e rëndë.

Vaksina nuk mund t'ju japë infeksion KOVID 19 dhe një kurë e plotë do të zvogëlojë mundësinë tuaj për t'u sëmurur rëndë.



**Mbajeni kartën tuaj të sigurt.
Ju gjithashtu mund të kontrolloni
aplikacionin e NHS.**

Vaksinimi, ndihma në mbrojtjen e atyre që janë më të rrezikuar

Nëse keni nevojë për më shumë informacion mbi vaksinimin kundër KOVID 19, ju lutemi vizitoni:

www.nhs.uk/conditions/coronavirus-covid-19/coronavirus-vaccination/coronavirus-vaccine/



UK Health
Security
Agency

© Crown copyright 2023

V7. 3M MAR 2023 (APS). Product Code: COV23WTAL Albanian
UK Health Security Agency gateway number: 2022801

Kjo fletëpalosje është gjithashtu e disponueshme në shkrimin
braille, si një video të gjuhës me shenja BSL, me shkronja të
mëdha, si një version leximi të lehtë, e përkthyer në mbi 26 gjuhët
dhe porositni nga www.healthpublications.gov.uk ose telefononi
0300 123 1002